



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT**

Tiranë, më 16.10.2019

**RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR MASAT SHTRENGUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Hyrje

Të nderuar anëtarë/e të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, jam caktuar relator për projektligjin “Për masat shtrenguese në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut është komision për dhënie mendimi.

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritja e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Përveç përmbushjes së qëllimit për ruajtjen e paqes e të sigurisë, ky projektligj ka si objektiv edhe përmbushjen e detyrimeve që vendi ynë ka si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së, që dalin në zbatim të kreut VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe rekomandimet e Task-Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Konkretisht, përmendim rekomandimin 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe rekomandimin 7, mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”.

Në këtë frymë vijnë edhe rekomandimet e Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës), i cili është organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë e Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, apo detyrimi për zbatimin e masave shtrënguese të BE-së në vijim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), në kuadër kjo edhe të aspiratës për anëtarësim në BE.

III. RIFORMULIMET SIPAS NENEVE

Neni 2

Sugjerohet riformulimi i pikës 1 të Nenit 2, si vijon:

“1. Ky ligj përcakton procedurën e vendosjes, të zbatimit, ndryshimit e shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i vendos, zbaton, ndryshon ose shfuqizon në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendimet e miratuara nga organizatat ndërkombëtare në të cilat ajo është shtet anëtar, si edhe me këtë ligj.”

Neni 4

1. Pika 4 e Nenit 4 të projektligjit, propozohet të riformulohet si vijon:

“**Entitet:** Një shoqatë, korporatë, partneritet, pronësi, ose individ që gëzon aftësi juridike të lidhë marrëveshje ose kontrata, të marrë përsipër detyrime, dhe të paguajë borxhe, të padisë dhe të gjykohet në të drejtën e vet, dhe të mbahet përgjegjës për veprimet e veta.”

2. Pika 10 e Nenit 4 të projektligjit sugjerohet të riformulohet si vijon:

““Organizime ligjore”, trustet, (një marrëveshje me anë të së cilës një person në mirëbesim mban pronën si pronar nominal për të mirën e një ose më shumë përfituesve) apo marrëveshje të tjera të ngjashme.”

Neni 6

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 1 të Nenit 6 si vijon:

“Dispozitat e këtij neni përcaktojnë procedurat e vendosjes, zbatimit, ndryshimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 3, të nenit 3, të këtij ligji.”

Neni 7

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 5 të Nenit 7 si vijon:

“Për qëllime të zbatimit të pikës 4, të këtij neni, organet përgjegjëse kanë detyrimin t’i propozojnë Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve nënligjore ose të nxjerrin vetë akte nënligjore me karakter të brendshëm.

Koment: *Nxjerrja e akteve nënligjore në shërbim të zbatimit të këtij ligji duhet të përcaktohet si detyrë e organeve përgjegjëse për të propozuar akte nënligjore në kuadër të zbatimit efektiv të ligjit.*

Neni 9

1. Në pikën 2 të Nenit 9, përmendet termi “Komiteti” për herë të parë në projektligj, por duke mos u përkufizuar si term. Për këtë, sugjerohet që termi “Komitet” të përfshihet te “Neni 4” përkufizime sipas përcaktimit si vijon:

“Komiteti: Për qëllime të zbatimit të këtij ligji krijohet Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komitetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme.”

Neni 10

1. Sugjerohet riformulimi i pikave të Nenit 10 si vijon:

“1. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji krijohet Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare. Komiteti drejtohet nga ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësministri i deleguar prej tij.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komitetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

3. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të organeve përgjegjëse për punët e jashtme, punët e brendshme, financat, ekonominë, bujqësinë, transportin, energjetikën, mbrojtjen, drejtësinë, të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Shërbimit Informativ të Shtetit, Bankës së Shqipërisë, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

4. Komiteti ka këto funksione:

a) I rekomandon ministrit për propozim në Këshillin e Ministrave, vendosjen, ndryshimin ose shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare;

b) I rekomandon ministrit përfshirjen në listën e OKB-së, sipas pikës 7, të nenit 9, të këtij ligji, të subjekteve ndaj të cilëve është vendosur, ndryshuar apo shfuqizuar masa shtrënguese;

c) Monitoron zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare të parashikuara në këtë ligj, në bazë të raporteve që dorëzojnë periodikisht organet përgjegjëse;

ç) Jep rekomandime për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare nga organet përgjegjëse;

d) Bashkërendon procesin e raportimit për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare pranë organizatave ndërkombëtare.

5. Në mbledhjet e Komitetit mund të thirren edhe përfaqësues të organeve të tjera përgjegjëse.

Neni 11

1. Sugjerohet riformulimi i shkronjës c të pikës 1 të Nenit 11 si vijon:

“c) ministria përgjegjëse për financat dhe strukturat në varësi të saj, Banka e Shqipërisë, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen financiare jobankare, për masat shtrënguese me karakter financiar;”

2. Sugjerohet që shkronja e) e pikës 2 të Nenit 11 të riformulohet si vijon:

“Vendosin dënimet administrative ndaj subjekteve që shkelin dispozitat e këtij ligji, sipas përcaktimeve të nenit 19, të këtij ligji. Kundër vendimit të organeve përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, subjektet pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. »

Koment :

Kjo shtesë synon që të harmonizojë dispozitat e ligjit me dispozitat e K.Pr.Administrative, konkretisht nenin 129 “Shterimi i mjeteve ligjore administrative”.

Neni 15

1. Sugjerohet që “Regjistri i të dhënave” të përfshihet tek “Neni 4 Përkufizime” si vijon:

“Regjistri i të dhënave: Me qëllim përpunimin e të dhënave për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare krijohet Regjistri i të Dhënave për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare, referuar si “Regjistri”. Regjistri mbahet nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

Neni 19

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 6 të Nenit 19 të projektligjit si vijon :

« Kundër vendimit të organeve përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, subjektet pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. »

Neni 20

1. Sugjerohet të hiqet pasi bie në kundërshtim me pikën 4 të Nenit 18; ose të harmonizohet me Nenin 18, duke u riformuluar si më poshtë:

“Nuk mund të paraqitet një kërkesë për kompensim kundër Republikës së Shqipërisë apo organit përgjegjës për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj për dëmin e shkaktuar nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me qëllim apo me faj nga ky i fundit.”

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R

KRYETARI

EDMOND LEKA

ULSI MANJA